

VENDIM
Nr. 627, datë 10.10.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 440, DATË 19.7.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË
KREDITIMIT STUDENTOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 114, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 440, datë 19.7.2023, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Studenti, i cili nuk është subjekt i përfitimeve prej akteve të tjera, që mbështetin studentin me bursa, mbështetje financiare apo përjashtime nga tarifat, ka të drejtë të aplikojë për kredi studentore pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, brenda muajit shkurt. Aplikimi shoqërohet me dokumentacionin, që vërteton regjistrimin si student në institucionin përkatës të arsimit të lartë dhe numrin e matrikullimit.”.

b) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga shpallja e listës me renditjen e kërkesave për të përfituar kredi studentore, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë ua paraqet këtë listë bankave të nivelit të dytë, të cilat kanë pranuar të ofrojnë kredinë studentore, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, me normën më të ulët të interesit. Brenda të njëjtut afat, njoftohen elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” edhe studentët për vijimin e procedurave dhe lidhjen e kontratës së kredisë me bankën përkatëse.”.

c) Pas pikës 14 shtohet pika 14/1, me këtë përmbajtje:

“14/1. Procedura e aplikimit, sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet pasi të jetë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare njoftimi i ministrit të arsimit për përfundimin e implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL. Deri në fillimin e funksionimit të sistemit, aplikimet për kredi studentore bëhen me kërkesë pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga AKFAL-i, deri në çastin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, SMIAL, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave të këtij vendimi, në fuqi në kohën e paraqitjes së tyre.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku